



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 23  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 204  
Prishtinë, më 19 shtator 2018, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Besa Baftiu, Enver Hoti, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Drita Millaku, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

**Munguan:** Miljana Nikoliq, Haxhi Avdyli.

**Të ftuar:** Zarife Miftari –UNFPA dhe Elvanda Gojani - K-10.

**Pjesëmarrës tjerë:** Flora Kryeziu-UNICEF, Ramiz Dukaj-KOPF, Ardita Sallahaj-UNFPA, Agnesa Xheladini – ARTPOLIS, Mrika Aliu-AMC, Kadri Gashi-PEN, Besnik Sherifi-UNFPA, Bledar Kalloci – PEN, Verona Bekteshi-KDI etj.

**Mbledhjen e kryesoi,** Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

**RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 13 dhe 27 qershor, 4, 11 dhe 18 korrik 2018;
3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Inspektoratin e Punës;
5. Takim me UNFPA-n dhe Koalicionin K-10;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

*Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 13 dhe 27 qershor, 4, 11 dhe 18 korrik 2018;**

Procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 13 dhe 27 qershor, 4, 11 dhe 18 korrik 2018, u miratuan pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018;**

**Kryetarja**, tha se, sot kemi për shqyrtim planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor. Në plan janë përfshirë projektligjet të cilat janë parapare në programin legjislativ. Po ashtu, është parapare edhe një monitorim nga sektori shëndetësisë, Ligjin për pajisje dhe produkte medicinale dhe propozoi monitorimin e Ligjit për siguri dhe shëndet në punë. Pasi që të gjithë jemi dëshmitar të incidenteve që kanë ndodhur gjatë këtij viti, ku kanë humbur jetën një numër i konsiderueshëm i punëtorëve në vendin e tyre të punës.

Anëtarët e komisionit e përkrahen propozimin për monitorimin e Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Monitorimi do të fillojë pas përfundimit të monitorimit të Ligjit për pajisje dhe produkte medicinale.

Komisioni pas diskutimeve të planit të punës për sesionin vjeshtor, nxori këtë:

### **V e n d i m**

Miratohet plani i punës së Komisionit për sesionin vjeshtor.

## **4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Inspektoratin e Punës;**

**Kryetarja**, tha se, sot kemi për shqyrtim në parim edhe Projektligjin për Inspektoratin e Punës.

Komisioni, shqyrtoi në parim, Projektligjin për Inspektoratin e Punës, dhe vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

### **R e k o m a n d i m**

1. Të miratohet, në parim, Projektligji për Inspektoratin e Punës.
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

## **5. Takim me UNFPA-n dhe Koalicionin K-10;**

**Kryetarja**, tha se, sot i kemi ftuar në takim përfaqësues nga UNFP-ja dhe Koalicioni K-10, për tu njoftuar me tepër rreth punës dhe aktiviteteve të tyre si dhe mundësisë së bashkëpunimit në të ardhmen me komisionin.

**Zarife Miftari –UNFPA**, tha se në cilësinë e analistes së Programit të UNFPA-së për Shëndet Seksual, Riprodhues dhe për Rini, do t'ua paraqes punën dhe objektivat e UNFPA-së në fushën e Shëndetit Seksual dhe Riprodhues. Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara, sivjet do të

kremtojë 19 vjetorin e punës në Kosovë. Kemi bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të gjitha institucionet e tjera relevante qendrore dhe komunale, OJQ-të, liderët fetarë, mediat dhe vendimmarrës të tjerë, për të kontribuar në përmirësimin e sistemit shëndetësor në Kosovë. UNFPA, me ekspertizën e vet në fushën e demografisë, shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese, kontribuon në avancimin e Shëndetit seksual dhe riprodhues përfshirë planifikimin familjar, Shëndetin maternal dhe të të porsalindurve; Parandalimin e HIV-it dhe AIDS-it; barazinë gjinore, përfshirë parandalimin e dhunës në baza gjinore dhe të drejtat riprodhuese; dinamikat e popullsisë dhe të dhënat;

UNFPA-ja me programin e vet ka kontribuar përmes avokimit, për zhvillim, investime dhe implementim të politikave të bazuara në fakte; Përkrahja e MSH-së për zhvillim të udhërrëfyesve dhe protokolleve në bazë të të cilave do të sigurohen shërbime shëndetësore cilësore, bazuar në standarde ndërkombëtare; ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes ngritjes së njohurive dhe shkathtësive të profesionistëve shëndetësorë; ngritje të kapaciteteve të punonjësve shëndetësorë për shëndetin riprodhues në emergjenca, si dhe përkrahjen e komunave për përfshirjen e shëndetit riprodhues në planet emergjente komunale; renovimin e materniteteve dhe donacionin e pajisjeve për sallat e lindjes; donacione të barërave kritike për shëndetin e nënave, donacion të mjeteve moderne të planifikimit familjar, edukim dhe promovim shëndetësor në nivel të komunitetit, promovim i sjelljeve të shëndetshme tek të rinjtë, grumbullimi i të dhënave etj.

Promovim dhe përkrahje e Ministrisë së Arsimit për edukatën seksuale gjithëpërfshirëse në shkolla; përkrahjen e iniciativave për të arritur grupet e marginalizuara të adoleshentëve dhe të rinjve, posaçërisht vajzave; Promovon lidhshirin dhe pjesëmarrjen e të rinjve.

Të gjitha këto, me qëllim që të sigurohen shërbime shëndetësore cilësorë, lehtë të qasshme dhe të përbalueshme, të cilat do t'u ofrohen të gjithë qytetarëve pa dallime gjinore, moshe, etnie, feje, statusi social etj. Me qëllim të avokimit të përbashkët të të gjithë atyre që punojnë në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues, UNFPA-ja ka përkrahur themelimin e Koalicionit K-10. UNFPA-ja vazhdon të jetë e përkushtuar që edhe mëtej, në forma dhe iniciativa të ndryshme, të vazhdojmë përkrahjen e Institucioneve të Kosovës, me qëllim final: shërbime shëndetësore sipas standardeve dhe normave ndërkombëtare, për të gjitha nënat dhe foshnjat tona, të rinjtë dhe të rejtat e vendit tonë, pa asnjë dallim.

**Elvanda Gojani – K-10**, tha se, në cilësi të koordinatorës së Koalicionit K-10, do t'ua paraqes përbërjen dhe punën e K10, që nga fillimi e deri më tani. Pjesë e K-10 janë 10 organizata joqeveritare. Shoqata “Adoleshentët Kosovarë” Shoqata për Edukim dhe Zhvillim të Shëndetësisë, “Aksioni për Nëna dhe Fëmijë”, Artpolis, Health For All, “Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit – Jeta / Vita”, Fondi Kosovar për Popullsi, Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmohatarë, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë, Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës. Koalicioni K10 është i krijuar dhe përkrahur nga Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara, zyra në Kosovë si dhe udhëhiqet nga Fondacioni për Nëna dhe Fëmijë. Koalicioni K10 është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në sektorin e shëndetësisë në Kosovë, sidomos shëndetin seksual dhe riprodhues. Sipas UNFPA-së, problemet me shëndetin riprodhues janë shkaku kryesor i shëndetit të dobët dhe vdekjes së grave që bartin fëmijë. Gratë e varfra, sidomos ato që jetojnë në vendet në zhvillim, vuajnë më shumë nga shtatzënitë e padëshiruara, vdekja dhe dëmtimet gjatë lindjes, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, dhuna në baza gjinore dhe probleme tjera në lidhje me sistemin riprodhues dhe sjellja seksuale.

Këto organizata janë bashkuar me qëllim të hapjes së dialogut në ngritjen e vetëdijesimit për shëndetin riprodhues dhe të drejtat e shëndetit riprodhues përmes avokimit, zhvillimin e politikave në fushën e shëndetit riprodhues si dhe promovimit të të drejtave të shëndetit riprodhues. Në realizimin e objektivës, K10 do të angazhohet në zhvillimin e një dialogu të gjerë social në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat nga shëndeti seksual dhe riprodhues, Zbatimin e aktiviteteve për rritjen e vetëdijes në lidhje me shëndetin riprodhues, monitorimin e zbatimit të politikave dhe legjislacionit për avancimin e të drejtave për shëndetin seksual dhe riprodhues, avokimin në lidhje me ndryshimet ligjore dhe politikat publike nga ana e institucioneve përkatëse, në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues. Ofrimin e asistencës për institucionet publike në zbatimin dhe draftimin e strategjive në fushën e shëndetit riprodhues. Avokimin për linja të veçanta buxhetore në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues. Misioni i K10 është që të përmirësojmë dhe të avancojmë strukturën ligjore, politikat publike, dhe të rrisë vetëdijesimin publik për shëndetin dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese përmes angazhimeve në avokim nga ana e anëtarëve themelues dhe partnerëve të Koalicionit.

**Kryetarja**, tha se ne si komision shprehim gatishmërinë tonë që edhe në të ardhmen të bashkëpunojmë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Pra, do të kemi një bashkëpunim të ngushtë gjatë shqyrtimit të legjislacionit nga fusha e shëndetit riprodhues.

**Fatmire Kollçaku**, tha se ky informacion në lidhje me punën e UNFPA-së dhe K10, është i mirëseardhur për ne si komision. Qenkeni pjesë e grupit punues për projektligjin për shëndetin riprodhues dhe besoj se do të ofroni ekspertizën tuaj në këtë fushë. Vendosja e orës në kurrikulën e arsimit për shëndetin riprodhues është e nevojshme që fëmijët të marrin informatën e duhur përmes arsimit e jo në ueb faqe të portaleve.

**Naser Rugova**, tha se i përgëzoj për punën dhe përkushtimin e përmirësimit të situatës dhe mirëqenies së qytetarëve përmes avokimit dhe ndihmës në avancimin e shëndetit riprodhues, pra edukimit të qytetarëve për shëndetin e tyre. Është e nevojshme si vend në tranzicion për informimin dhe edukimin e qytetarëve përmes kurrikulës së arsimit në klasën e tetë dhe të nëntë, si dhe në shkollimin e mesëm t'i informojmë nxënësit për shëndetin riprodhues. Unë propozoj se ne i si komision, institucionet edhe organizatat tjera, të zhvillojmë një fushatë për promovimin për shëndetin riprodhues si dhe të avokojmë që të kemi linjë të veçante buxhetore për edukimin dhe planifikimin familjar.

**Time Kadrijaj**, tha se i falënderojmë për këtë paraqitje dhe punën që kanë bërë UNFPA-ja dhe K10. Edhe ne ofrojmë gatishmëri për të bashkëpunuar në të ardhmen në realizimin e fushatave dhe avokimin për shëndetin riprodhues. Bashkëpunimin që keni me institucionet shëndetësore, në këtë rast ju rekomandoj që të shtohet bashkëpunimi me qendrat e mjekësisë familjare nëpër qytetet tjera apo nëpër fshatra si dhe të shpërndani broshurat që edhe qytetaret nëpër fshatra ti marrin këto broshura që të njoftohen nga afër për shëndetin riprodhues.

**Flora Brovina**, tha se i falënderojmë për këtë paraqitje dhe punën që kanë bërë UNFPA-ja dhe K10 deri me tani. Edukimi për shëndetin riprodhues është me se i nevojshëm për qytetaret tanë. Komisioni është i gatshëm për të bashkëpunuar në të ardhmen për edukimin e shëndetit seksual riprodhues. Ne duhet të kemi një pasqyre të qartë sa i përket popullatës për shëndetin e tyre, me qëllim që të kemi më të lehtë se çfarë politika shëndetësore duhet ti nxjerrim në të ardhmen.

**Kryetarja**, tha se do të keni edhe më tutje mbështetjen tonë si komision dhe besojmë shumë në bashkëpunimin më të ngushtë në të ardhmen në adresimin e këtyre problematikave në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Kryetarja e Komisionit,**

---

**Besa BAFTIU**